

KONKURS**Auditor i Teknologjisë Informative (m/f)****Kualifikimet:**

- Kualifikim universitar në Shkenca Kompjuterike ose të ngjashme;
- Certifikimi i preferuar në CISA, CISSP apo të tjera;
- Mbi tre (3) vite përvojë pune në fushën e TI, preferohet përvojë pune në auditim ose sektorin bankarë;
- Kuptimi i fushave të shumta të teknologjisë duke përfshirë zhvillimet e softuerit, Windows, menaxhimin e bazës së të dhënave dhe sistemet dhe rrjetet;
- Kuptimi i standardeve të sigurisë së informacionit, praktikat më të mira për sigurimin e sistemeve kompjuterike, ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Aftësi të mira në komunikimit dhe prezantim;
- Shkathtësi në caktimin e objektivave dhe planifikimin e punës;
- I/e aftë të punojë në ekip dhe në mënyrë të pavarur;
- Nivel i avancuar i Gjuhës Angleze dhe përdorimit të Microsoft Office-it.

Përgjegjësitë:

- Kryen auditimet e TI-së si udhëheqës i ekipit dhe anëtar përkras në auditime tjera;
- Shqyrton kontrollet e brendshme të bankës për fushën e IT-së dhe sigurisë së informacionit, vlerëson dizajnin dhe efektivitetin e kontrolleve, përcakton ekspozimin ndaj rrezikut dhe zhvillon qasje të përshtatshme të auditimit;
- Kryen procedura efikase dhe efektive të auditimit të TI-së dhe sigurisë së informacionit;
- Kryen testime të rregullta të auditimit dhe ofron rekomandime për rreziqet e identifikuar;
- Kryen vlerësimin dhe testimin e kontrolleve të aplikacioneve në Bankë;
- Rishikon sistemet e bankës për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, kodin e sjelljes si dhe implementimin e politikave dhe procedurave të brendshme të Bankës;
- Përgatit dhe monitoron planin dhe programet e auditimit të Brendshëm për fushën e TI-së dhe sigurisë së informacionit;
- Diskuton rezultatet e auditimit të kryera me personin përgjegjës të njësisë / degës / shërbimit dhe jep rekomandime rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për përmirësimin e gjendjes;
- Bënë sistemimin dhe indeksimin e letrave të punës dhe dosjes së auditimit për auditimet që mbulon;

- Përpilon draft raporte dhe raporte për auditimet e kryera dhe raporte tremujore/vjetore, si dhe komunikon çështjet komplekse teknike në terma të thjeshtuar tek personeli përkatës i bankës dhe linja raportuese;
- Monitoron implementimin e rekomandimeve të dhëna nga raportet e auditimit;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësi të caktuara kryen edhe punë tjera sipas kërkesës nga Mbikëqyrësi Direkt.

Procedura e aplikimit:

Plotësoni formularin për aplikim i cili gjendet në këtë link: <https://www.bpbbank.com/forma-e-aplikimit-per-punesim/>

Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë.

Afati i aplikimit është deri me datë: 01.07.2019